

RELACION PËR PROJEKTLIGJIN “PËR SHËRBIMET DIGJITALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për Shërbimet Digjitale në Republikën e Shqipërisë”, është propozim i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, bazuar në pikën 2 të nenit 100, të Kushtetutës, dhe ka për qëllim të kontribuojë në mirëfunksionimin e shërbimeve ndërmjetëse në Republikën e Shqipërisë, duke vendosur rregulla të harmonizuara për një mjedis online të sigurt, të parashikueshëm dhe të besueshëm, që i përgjigjet zhvillimeve teknologjike dhe përdorimit masiv të teknologjisë digjitale dhe shërbimeve online duke siguruar mbrojtjen e të drejtave themelore si dhe mbrojtjen më të mirë të konsumatorit, marrësit të shërbimeve ndërmjetëse.

Projektligji përcakton rregulla për ofrimin e shërbimeve ndërmjetëse në Republikën e Shqipërisë, të harmonizuara me praktikën e Bashkimit Evropian dhe krijon në veçanti, një kuadër përjashtimi të kushtëzuar nga përgjegjësia, për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse, rregulla dhe detyrime specifike për kujdesin e duhur në mjedisin online, të përshtatura sipas kategorive të ofruesve të shërbimeve ndërmjetëse dhe rregulla për zbatimin dhe garantimin e zbatimit të këtij ligji, përfshirë ato të lidhura me bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet autoriteteve kompetente në Republikën e Shqipërisë, të harmonizuara me praktikën e Bashkimit Evropian.

Ky projektligj, synon të transpozojë pjesërisht Rregulloren (EU) 2022/2065 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 19 tetori 2022, “Për një Treg të Vetëm për Shërbimet Digjitale dhe ndryshimin e Direktivës 2000/31/EC (Akti për Shërbimet Digjitale – DSA).

Projektligji lidhet me përmbushjen e Piketave Përmbyllëse të Kapitullit 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Media” si dhe angazhimet në Reformën e Agjendave, të miratuar me Vendimin nr. 621, datë 10.10.2024, “Për miratimin e dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027”, në kuadër të instrumentit të BE, “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”.

Përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritit evropian përmes hartimit të një ligji të ri “Për shërbimet digjitale në Republikën e Shqipërisë” është i nevojshëm dhe i shërben krijimit të një kuadri ligjor gjithëpërfshirës që rregullon ofrimin e shërbimeve ndërmjetëse në mjedisin digjital, garanton mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve, rrit transparencën dhe përgjegjshmërinë e platformave online, forcon mbrojtjen e konsumatorëve dhe mundëson trajtimin efektiv të aktiviteteve dhe përmbajtjes së paligjshme.

Aktualisht rregullimet për ndërmjetësit për shërbimet e shoqërisë së informacionit trajtohen në mënyrë shumë pjesore dhe të kufizuar në nenet 15-20, të ligjit nr. 10128 datë 11.5.2009 “Për tregtinë elektronike” të ndryshuar. Këto nene në ligjin shqiptar transpononin nenet 12-14 të Direktivës 2000/31/EC të BE-së që janë shfuqizuar nga Rregullorja e (BE) 2022/2065, dhe janë zëvendësuar me një rregullim të plotë, gjithëpërfshirës me përcaktime të qarta për secilën kategori të ndërmjetësave të shërbimeve të shoqërisë së informacionit që i përgjigjen zhvillimeve aktuale të teknologjisë dhe mjedisit digjital.

Përmes harmonizimit të legjislacionit shqiptar me Rregulloren (BE) 2022/2065 (Digital Services Act), në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritit evropian

synohet krijimin e një mjedisi digjital të sigurt, transparent dhe të besueshëm si dhe mirëfunksionim i shërbimeve digjitale.

Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri për shërbimet digjitale përbën një plotësim të rëndësishëm të kuadrit ligjor që i përgjigjet zhvillimeve digjitale, për mbrojtjen më të mirë të marrësit të shërbimeve nga përmbajtje apo aktivitete të paligjshme sipas praktikës së BE.

II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Hartimi dhe miratimi i këtij projektligji, është në përputhje me Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2026, si dhe Piketat Përmbyllëse të Kapitullit 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Media”.

Ai gjithashtu lidhet me përmbushjen e angazhimeve në kuadër të Reformes së Agjendave, e miratuar me Vendimin nr. 621, datë 10.10.2024, “Për miratimin e dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027”, në kuadër të instrumentit të BE, “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji “Për shërbimet digjitale në Republikën e Shqipërisë” hartohet në kuadër të procesit të integrimit dhe përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE, në përputhje me angazhimet e Republikës së Shqipërisë në kuadër të Kapitullit 10 “Shoqëria e informacionit dhe media”, Agjendës së Reformave dhe integrimit gradual në Tregun e Vetëm Digjital të BE.

Projektligji synon krijimin e një kuadri të harmonizuar rregullator për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse online, me qëllim garantimin e një mjedisi digjital më të sigurtë, transparent dhe të besueshëm për përdoruesit dhe bizneset.

Përparësitë kryesore të projektligjit lidhen me përafrimin e legjislacionit kombëtar me standartet e BE; forcimin e transparencës dhe llogaridhënies së ndërmjetësave të ofrimit të shërbimeve, si: transmetuesit e thjeshtë, ruajtësit e përkohshëm të informacionit, hostuesit, përfshirë platformat online; mbrojtjen e përdoruesve dhe konsumatorëve në ambientin digjital; krijimin e mekanizmave të standardizuara sipas praktikës së BE-së për veprimin kundër aktiviteteve apo përmbajtjeve të paligjshme online, si dhe forcimin e bashkëpunimit institucional në tregun digjital.

Projektligji adreson problematikat që lidhen me mungesën e një kuadri të posaçëm për rregullimin e shërbimeve digjitale, mungesën e detyrimeve të harmonizuara për platformat online, si dhe nevojën për mekanizma më efektive për transparencën, mbrojtjen e përdoruesve, të dhënave personale të tyre dhe trajtimin e përmbajtjeve të paligjshme.

Miratimi i projektligjit pritet të sjellë efekte pozitive në aspektin juridik, institucional dhe ekonomik, duke përmirësuar standartet e sigurisë dhe besueshmërisë online, duke rritur mbrojtjen e përdoruesve, duke nxitur zhvillimin e ekonomisë digjitale dhe të një tregu digjital

më të besueshëm dhe konkurrues, si dhe duke kontribuar në avancimin e procesit të integritimit evropian të Republikës së Shqipërisë.

Objektivat kryesore të këtij projektligji janë:

1. *Krijimi i një mjedisi digjital më të sigurtë në Shqipëri*
 - Mbrojtja e përdoruesve online nga përmbajtja, produktet dhe shërbimet e paligjshme në internet.
 - Krijimi i procedurave efektive për autoritetet kompetente në lidhje me raportimin dhe trajtimin e përmbajtjes së paligjshme online.
2. *Rritja e mbrojtjes së të drejtave themelore të përdoruesve*
 - Garantimi i lirisë së shprehjes, të drejtës për informacion dhe ruajtjes së të dhënave personale.
 - Sigurimi i procedurave të drejta dhe transparente kur platformat kufizojnë, heqin përmbajtje, apo pezullojnë llogari online.
 - Forcimi i mbrojtjes së të miturve në mjedisin online.
3. *Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së ofruesve të shërbimeve ndërmjetëse online*
 - Detyrimi i platformave online për publikimin e raporteve të transparencës.
 - Transparencë mbi reklamat online dhe sistemet e rekomandimit.
 - Informim i qartë i përdoruesve për kushtet e përdorimit dhe vendimet e moderimit.
4. *Vendosja e detyrimeve për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse*
 - Përcaktimi i detyrimeve sipas kategorisë së shërbimit (mere conduit, caching, hosting, për platformat online dhe platformat online shumë të mëdha).
 - Krijimi i mekanizmave për bashkëpunim me autoritetet kompetente.
5. *Forcimi i mbrojtjes së konsumatorëve në tregtinë elektronike*
 - Rritja e gjurmueshmërisë së tregtarëve online në platformat online.
 - Pengimi i shitjes së produkteve të paligjshme ose të pasigurta.
 - Rritja e besimit të konsumatorëve në shërbimet digjitale.
6. *Krijimi i një sistemi efektiv mbikëqyrjeje dhe zbatimi*
 - Caktimi i një autoriteti kompetent dhe të pavarur si Koordinator i Shërbimeve Digjitale (Digital Services Coordinator).
 - Sigurimi i bashkëpunimit ndërinstitucional edhe me autoritetet e vendeve të BE-së, sipas modelit të DSA.
7. *Përafrimi i legjislacionit shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian*
 - Harmonizimi i kuadrit ligjor shqiptar me Rregulloren (BE) 2022/2065.

Projektligji pritet të përmirësojë mekanizmat e raportimit dhe trajtimit të përmbajtjeve të paligjshme, të forcojë mbrojtjen e konsumatorëve dhe të miturve në internet, si dhe të rrisë llogaridhënien e platformave që operojnë ose ofrojnë shërbime për përdoruesit shqiptarë, pavarësisht vendit të themelimit të tyre.

Nga pikëpamja ekonomike dhe rregullatore, projektligji pritet të harmonizojë kuadrin ligjor shqiptar me acquis të BE, duke rritur sigurinë juridike, duke nxitur besimin në tregun digjital dhe lehtësuar integrimin e Shqipërisë në tregun e përbashkët digjital evropian.

Në aspektin institucional, projektligji do të mundësojë forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse dhe koordinuese të autoriteteve kompetente, si dhe krijimin e mekanizmave të nevojshëm për bashkëpunim me autoritetet homologe të shteteve anëtare të BE në fushën e shërbimeve digjitale.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, në përputhje me rendin juridik të brendshëm që rregullon fushën e komunikimeve elektronike, shërbimeve të shoqërisë së informacionit, mbrojtjes së konsumatorit, mbrojtjes së të dhënave personale dhe sigurisë kibernetike, bazuar në nevojat e tregut dhe reflektimin e zhvillimeve teknologjike.

Gjithashtu ky projektligj është hartuar në përputhje me angazhimet në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin Evropian dhe acquis të BE-së.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji synon transpozimin e pjesshëm të Rregullores (BE) 2022/2065 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 19 tetori 2022, për një Treg të Vetëm për Shërbimet Digjitale dhe ndryshimin e Direktivës 2000/31/EC, e njohur si Akti për Shërbimet Digjitale – DSA.

Kjo rregullore ka rëndësi të veçantë se është akti i parë ligjor gjithëpërfshirës në nivel global i hartuar posaçërisht për të rregulluar veprimtaritë e shërbimeve ndërmjetëse që operojnë në mjedisin online, përfshirë shërbimet e hostimit, platformat shumë të mëdha online dhe motorët shumë të mëdhej të kërkimit online.

Dispozitat e projektligjit reflektojnë kërkesat e acquis të BE lidhur me përgjegjësitë e ofruesve të shërbimeve të ndërmjetme, mekanizmat e raportimit dhe trajtimit të përmbajtjes së paligjshme, transparencën e platformave online, mbrojtjen e përdoruesve dhe mbikëqyrjen rregullore.

Projektligji siguron një nivel të lartë përafrimi me acquis të BE. Në projektligj nuk janë përafruar dispozitat që lidhen me kompetencat ekskluzive të Komisionit Evropian si dhe me procedurat e brendshme që ndiqen nga Komisioni Evropian. Rregullimet janë përshtatur në masën e nevojshme me kuadrin institucional dhe kompetencat e autoriteteve kombëtare për rregullimin e shërbimeve ndërmjetëse në Republikën e Shqipërisë. Po ashtu dispozitat që rregullojnë funksionimin e platformave shumë të mëdha online dhe motorët shumë të mëdhenj të kërkimit online, do të shfuqizohen në momentin e hyrjes në fuqi të Traktatit të Aderimit, me qëllim shmangien e mbivendosjes me kompetencat që ushtrohen nga institucionet e BE, sipas Aktit të Shërbimeve Digjitale.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 61 nene, të organizuara në pesë Krerë si më poshtë:

Kreu I — Dispozita të përgjithshme, përfshin tri nene që transpozojnë nenet 1, 2 dhe 3 të Rregullores së BE-së për DSA.

Neni 1, “Qëllimi i ligjit”, përcakton qëllimin e ligjit, që konsiston në kontribuimin në funksionimin efektiv të tregut kombëtar për shërbimet ndërmjetëse, përcaktimin e rregullave

të harmonizuara për një mjedis online të sigurtë, të parashikueshëm dhe të besueshëm. Gjithashtu ai përcakton rregulla të harmonizuara për perjashtimin e kushtëzuar nga përgjegjësitë në ofrimin e shërbimeve ndërmjetëse në tregun e brendshëm.

Neni 2, “Fusha e zbatimit”, përcakton që ky ligj zbatohet për shërbimet ndërmjetëse të ofruara për marrësit e shërbimit që kanë vendin e tyre të themelimit, ose ndodhen në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht se ku është themeluar ofruesi i këtyre shërbimeve. Në këtë nen saktësohet se ky ligj nuk zbatohet për asnjë shërbim tjetër që nuk është shërbim ndërmjetësimi. Gjithashtu në këtë nen në harmoni të plotë me përcaktimet e nenit 2, të Rregullores së BE 2022/2065/EU, referohen rregullat e përcaktuara nga akte të tjera ligjore që rregullojnë apo plotësojnë rregullimet sipas këtij ligji, të cilat nuk çenohen nga ky ligj.

Neni 3, “Përkufizime”, jep përkufizimet e përdorura në këtë ligj, me qëllim garantimin e qartësisë juridike për termat e përdorura si për kategoritë e ndërmjetësive, dhe për terma të tjerë të përdorur. Këto përkufizime janë të harmonizuara me terminologjinë e përdorur në Aktin e Shërbimeve Digjitale si dhe vijnë të harmonizuara me legjislacionin përkatës shqiptar.

Kreu II — REGJIMET E PËRGJEGJËSISË PËR SHËRBIMET E NDËRMJETËSIMIT

Neni 4, Transmetimi i thjeshtë “Mere Conduit”. Ky nen transpozon plotësisht nenin 4, të Rregullores së BE 2022/2065/EU dhe përcakton regjimin e përgjegjësisë të kushtëzuar për kategorinë e ofruesve të shërbimeve ndërmjetëse, veprimtaria e të cilëve konsiston ekskluzivisht në transmetimin e thjeshtë të informacionit të ofruar nga një marrës i shërbimit, ose ofrimin e aksesit në një rrjet komunikimi si përmes ofrimit të aksesit në internet. Sipas kësaj dispozite, ofruesi i shërbimeve të transmetimit të thjeshtë “Mere Conduit”, nuk është përgjegjës për informacionin e transmetuar ose të vënë në dispozicion nga marrësi i shërbimit, nëse përmbushen tre kushte kumulative: ofruesi nuk e inicion transmetimin; ofruesi nuk përzgjedh marrësin e transmetimit; dhe ofruesi nuk zgjedh ose modifikon informacionin e përmbajtur në transmetim. Zbatimi i këtij neni nuk ndikon në mundësinë që gjykata ose një autoritet kompetent, t’i kërkojë ofruesit të shërbimit ndërprerjen ose të parandalojë një shkelje, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 5, Ruajtja e përkohshme e informacionit “Caching”. Ky nen transpozon plotësisht nenin 5, të Rregullores së BE 2022/2065/EU dhe përcakton regjimin e përgjegjësisë të kushtëzuar për kategorinë e shërbimeve të ndërmjetësimit “Caching”, i cili i referohet ruajtjes automatike, të ndërmjetme dhe të përkohshme të informacionit të kryer për qëllimin e vetëm të memorizimit të shpejtë “Caching”. Ofruesi i shërbimit nuk do të jetë përgjegjës për ruajtjen automatike, të ndërmjetme dhe të përkohshme të atij informacioni, për sa kohë që ruajtja shërben vetëm për ta bërë transmetimin e mëtejshëm të informacionit për marrësit e tjerë të shërbimit më efikas, ose më të sigurt me kërkesën e tyre, sipas disa kushteve të detajuara në të. Gjithashtu ky nen nuk çenon mundësinë që një autoritet kompetent ose gjyqësor, në përputhje me legjislacionin kombëtar të zbatueshëm, të kërkojë që ofruesi i shërbimit të ndërpresë ose të parandalojë një shkelje.

Neni 6, Shërbimi i ruajtjes të informacionit “Hosting” ose ofrimi i shërbimeve të hostimit. Sipas dispozitave të këtij neni që transpozon nenin 6, të Rregullores së BE-së, parashikon që ofruesi i shërbimit nuk do të jetë përgjegjës për informacionin e ruajtur me kërkesë të një marrësi të shërbimit kur ofrimi i shërbimit konsiston në ruajtjen e informacionit të dhënë nga një marrës i shërbimit, për sa kohë që ofruesi nuk ka dijeni për veprimtarinë e paligjshme ose përmbajtjen e paligjshme të marrësit të shërbimit, si dhe me klauzolën që ofruesi vepron

menjëherë për të hequr ose çaktivizuar aksesin në përmbajtje të paligjshme kur merr dijeni. Zbatimi i këtij neni nuk çënon mundësinë që një autoritet kompetent ose gjyqësor, në përputhje me legjislacionin kombëtar të zbatueshëm, të kërkojë që ofruesi i shërbimit të ndërpresë ose të parandalojë një shkelje. Parashikimet e këtij neni si dhe neneve 4 dhe 5, më sipër janë të ngjashme me ato që ekzistojnë aktualisht në ligjin nr. 10128/2009 dhe mbështeten në mekanizmat e njoftimit dhe veprimit “*take notice and down*”.

Neni 7, Hetimet vullnetare me nismën e ofruesit dhe përputhshmëria ligjore. Ky nen është në përputhje të plotë me nenin 7, të Rregullores së BE-së për DSA dhe parashikon që ofruesit shërbimeve ndërmjetëse nuk e humbasin të drejtën e përjashtimit nga përgjegjësia sipas parashikimeve në nenet 4, 5, dhe 6, të këtij ligji, nëse kryejnë investigime vullnetare me nismën e tyre ose veprimtari të tjera që synojnë zbulimin, identifikimin dhe heqjen e përmbajtjes së paligjshme, me qëllim sigurimin e pajtueshmërisë ligjore.

Neni 8, Mungesa e detyrimit të përgjithshëm për monitorim Ky nen përcakton një nga parimet më themelore të Aktit të Shërbimeve Digjitale duke saktësuar që ofruesve të shërbimeve ndërmjetëse në përputhje me praktikën e BE nuk u imponohet asnjë detyrim i përgjithshëm monitorimi.

Përmbajtja e neneve 4 deri në nenin 8, të projektligjit që synojnë transpozimin e neneve respektive të DSA, janë të ngjashme me rregullimet e miratuara me ligjin nr. 10128/2009 për tregtinë elektronike, por që me Rregulloren e DSA-së pasurohen dhe vijnë me dispozita të plota, të detajuara, të qarta për secilën nga kategoritë e ofruesve të shërbimeve ndërmjetëse sic prezantohet në seksionet më poshtë.

Neni 9, Urdhrat për të vepruar kundër përmbajtjes së paligjshme. Ky nen është plotësisht i harmonizuar me nenin 9, të DSA-së dhe përcakton rregulla për përmbajtjen e urdhërit/ave që lëshohet nga autoritetet kompetente kundër një ose më shumë elementeve specifike të përmbajtjes apo aktiviteti të paligjshme. Sipas kësaj dispozite ky urdhër lëshohet nga autoritetet gjyqësore ose administrative kombëtare përkatëse, në bazë të ligjit kombëtar të zbatueshëm dhe pas marrjes së tij ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse informojnë autoritetin që lëshon urdhrin, ose çdo autoritet tjetër të përcaktuar në urdhër, për zbatimin e urdhrit pa vonesë, duke specifikuar nëse duhet dhe kur iu dha efekt urdhrit. Në vijim përcaktohen elementet e nevojshme që duhet të përmbajë urdhri i lëshuar si dhe procedura vijuese duke përfshirë edhe institucionin e Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale, i cili bashkëpunon me autoritetet përkatëse. Nënvizohet gjithashtu se kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë nen nuk çënojnë zbatimin e kërkesave sipas procedurave civile dhe penale.

Neni 10, Urdhrat për dhënie informacioni. Ky nen është plotësisht i harmonizuar me nenin 10, të DSA-së dhe përcakton kërkesat për urdhrat që i kërkojnë një ofruesi të shërbimit ndërmjetësues informacion specifik për një ose më shumë marrës specifikë të shërbimit. Me këtë dispozitë sqarohen kushtet që duhet të plotësojë urdhri para se të nxirret dhe elementët që duhet të përmbajë ai. Dispozitat vijnë me mënyrën si bëhet transmetimi i urdhrit nga autoriteti lëshues i urdhrit, kërkesat e Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale në lidhje me zbatimin e këtij neni dhe kohën se kur urdhrit i jepet efekt. Gjithashtu me anë të këtij neni saktësohet si dhe në nenet e mësipërme që kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në të, nuk çënojnë kërkesat sipas së drejtës procedurale civile dhe penale.

Kreu III — Detyrimet e kujdesit të duhur për një mjedis online transparent dhe të sigurt;

Kreu III, është kreu më i gjatë i projektligjit i përbërë nga gjasht seksione ku përcaktohen rregullime të detajuara për secilën kategori të ndërmjetësave të shërbimeve.

Neni 11, Caktimi i pikave të kontaktit për autoritetet, sipas këtij neni ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse, duhet të caktojnë një pikë të vetme elektronike kontakti për komunikim me autoritetet shqiptare. Ata janë të detyruar të publikojnë informacion të qartë, të aksesueshëm dhe të përditësuar në mënyrë që pika e tyre e kontaktit të mund të identifikohet lehtësisht. Komunikimi nga autoritetet kompetente dhe gjyqësore kryhet në shqip kur ofruesi është një shoqëri shqiptare, dhe në anglisht kur ofruesi është i huaj.

Neni 12, Pikat e kontaktit për marrësit e shërbimit, ky nen përcakton detyrime për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse; së pari detyrimin për të krijuar një pikë të vetme kontakti, për t'u mundësuar marrësve të shërbimit të komunikojnë drejtpërdrejt dhe me shpejtësi me ta, me mjete elektronike dhe në një mënyrë të lehtë dhe së dyti të bëjnë publik informacionin e nevojshëm për marrësit e shërbimit në mënyrë që të identifikojnë lehtësisht dhe të komunikojnë me pikat e tyre të vetme të kontaktit.

Neni 13, Përfaqësuesi ligjor, ky nen parashikon se ofruesit e huaj të shërbimeve ndërmjetëse që operojnë në Shqipëri, duhet të emërojnë një përfaqësues ligjor, ose në Shqipëri ose në një shtet anëtar të BE. Ky përfaqësues shërben si kontakti zyrtar për autoritetet shqiptare dhe Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale, me kompetenca dhe burime të mjaftueshme për të siguruar pajtueshmëri dhe bashkëpunim. Përfaqësuesi mban përgjegjësi për mospajtueshmërinë, krahas vetë ofruesit. Ofruesit duhet të njoftojnë Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale për të dhëna të plota të kontaktit të përfaqësuesit. Emërimi i një përfaqësuesi nuk nënkupton themelimin e ofruesit në Shqipëri.

Neni 14, Kushtet dhe afatet, ky nen përcakton detyrime lidhur me transparencën për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse lidhur me kushtet dhe afatet e tyre. Ofruesit duhet të bëjnë të ditur qartë çdo kufizim mbi përdorimin e shërbimeve të tyre, përfshirë politikat, procedurat dhe mjetet e përdorura për moderimin e përmbajtjes, qoftë algoritmik ose njerëzor, dhe rregullat e sistemeve të tyre të brendshme të ankesave. Një informacion i tillë duhet të paraqitet në gjuhë të thjeshtë, të aksesueshme dhe të lexueshme nga pajisjet dhe përdoruesit duhet të informohen për çdo ndryshim të rëndësishëm. Kur shërbimet u drejtohen të miturve, kushtet duhet të shpjegohen në një mënyrë që fëmijët mund ta kuptojnë. Kufizimet duhet të zbatohen me kujdes, në mënyrë objektive dhe proporcionale, duke respektuar të drejtat themelore si liria e shprehjes dhe pluralizmi mediatik. Platformat shumë të mëdha online dhe motorët e kërkimit shumë të mëdhenj, kanë detyrime shtesë: duhet të ofrojnë përmbledhje koncize të kushteve dhe afateve të tyre, përfshirë mjetet juridike dhe mekanizmat e kompensimit, dhe t'i publikojnë ato në të gjitha gjuhët zyrtare të EU të shteteve anëtare ku operojnë.

Neni 15, Detyrimet e raportimit të transparencës për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse, ky nen përcakton detyrimin e raportimit vjetor të transparencës për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse. Ofruesit duhet të publikojnë raporte të qarta, të aksesueshme dhe të lexueshme nga pajisjet, raporte të lexueshme që detajojnë aktivitetet e tyre të moderimit të përmbajtjes, përfshirë urdhrat e marra nga autoritetet, njoftimet e paraqitura nga përdoruesit dhe sinjalizuesit e besuar, veprimet e ndërmarra dhe përdorimin e mjeteve të automatizuara. Raportet duhet të mbulojnë gjithashtu moderimin e kryer me nismën e vet ofruesit, trajnimin e moderatorëve, kufizimet e zbatuara ndaj përmbajtjes së përdoruesit, dhe ankesat e trajtuara përmes sistemeve të brendshme. Ofruesit duhet të bëjnë të ditur saktësinë dhe masat mbrojtëse të mjeteve të automatizuara të moderimit. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme përjashtohen nga këto detyrime. Në pikat vijuese të këtij neni ka detyrime për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse në lidhje me informacionin që përcillet, mënyrën sesi duhet të jetë,

ankesat, numrin e ankesave të marra nëpërmjet sistemeve të brendshme të trajtimit të ankesave në përputhje me kushtet dhe afatet e ofruesit bazën për ato ankesa, vendimet e marra në lidhje me ato ankesa, kohën mesatare të nevojshme për marrjen e atyre vendimeve dhe numrin e rasteve kur ka pasur ndryshime të këtyre vendimeve dhe për çdo përdorim të mjeteve të automatizuara për qëllimin e moderimit të përmbajtjes. Gjithashtu në lidhje me koordinatorin e Shërbimeve Digjitale, në bashkërendim me autoritetet kompetente, miraton modele dhe periudha raportimi të harmonizuara në përputhje me aktet zbatuese të EU.

Seksioni 2 — Dispozita shitesë të zbatueshme për ofruesit e shërbimeve të hostimit, përfshirë platformat online

Neni 16, Mekanizmat e njoftimit dhe veprimit, ky nen nëpërmjet dispozitave të tij, siguron llogaridhënie duke detyruar ofruesit e shërbimeve të hostimit të vendosin mekanizma për t'i lejuar çdo individ ose subjekti t'u njoftojë atyre praninë në shërbimin e tyre të elementeve specifike të informacionit që individ ose subjekti i konsideron përmbajtje të paligjshme. Ky nen përcakton detyrimin për ofruesit e shërbimeve të hostimit për të zbatuar dhe bërë efektiv njoftimin dhe mekanizmat e veprimit. Këto sisteme duhet t'u lejojnë individëve ose subjekteve të njoftojnë elektronikisht ofruesit për përmbajtje specifike të paligjshme në një mënyrë të qartë, të aksesueshme dhe miqësore për përdoruesin.

Njoftimet duhet të jenë të sakta dhe të mbështetura, përfshirë arsyet e paligjshmërisë, vendndodhjen e saktë të përmbajtjes dhe të dhënat e kontaktit të njoftuesit, me përjashtim për materialin e abuzimit seksual të fëmijëve. Një njoftim i vlefshëm u jep ofruesve dijeni faktike për përmbajtje të paligjshme, duke nxitur detyrimin e tyre për të vepruar. Ofruesit duhet të konfirmojnë marrjen e njoftimeve, të informojnë njoftuesit për vendimet e tyre dhe të japin informacion mbi mjetet e disponueshme të ankimit. Të gjitha vendimet duhet të merren me kujdes, objektivitet dhe në kohë. Kur ata përdorin mjete të automatizuara për atë përpunim ose vendimmarrje, ata do të përfshijnë informacion të mëtejshëm. Ofruesit e shërbimeve të hostimit përpunojnë çdo njoftim që marrin sipas mekanizmave të përmendur në këtë nen dhe marrin vendimet e tyre për informacionin me të cilin lidhen njoftimet, në një mënyrë koherente, të kujdesshme, jo arbitrare dhe objektive.

Neni 17, Deklarata e arsyeve, kërkon që ofruesit e shërbimeve të hostimit, t'u japin përdoruesve një deklaratë të qartë dhe specifike të arsyeve sa herë që kufizojnë përmbajtjen ose llogaritë për shkak të paligjshmërisë ose papajtueshmëri me kushtet e tyre të shërbimit. Kufizimet mund të përfshijnë heqjen ose uljen në renditje të përmbajtjes, pezullimin e pagesave, ose mbylljen e llogarive. Deklarata duhet të përshkruajë llojin, shtrirjen dhe kohëzgjatjen e kufizimit, faktet dhe rrethanat pas vendimit, nëse janë përfshirë njoftime ose mjete të automatizuara, dhe bazën ligjore ose kontraktore mbi të cilën është mbështetur. Ajo duhet gjithashtu t'i informojë përdoruesit për mundësitë e disponueshme të ankimit, siç janë mekanizmat e ankesave, zgjidhja e mosmarrëveshjeve, ose shqyrtimi gjyqësor. Detyrimi zbatohet sa herë që ofruesit kanë të dhënat e kontaktit të përdoruesit. Gjithashtu informacioni i dhënë nga ofruesit e shërbimeve të hostimit në përputhje me këtë nen, duhet të jetë i qartë dhe lehtësisht i kuptueshëm dhe sa më i saktë dhe specifik që të jetë e mundur në rrethanat e dhëna. Informacioni duhet, në veçanti, të jetë i tillë që t'i lejojë në mënyrë të arsyeshme marrësit të shërbimit në fjalë të ushtrojë në mënyrë efektive mundësitë për zhdëmtim.

Neni 18, Njoftimi mbi dyshimet për vepra penale, dispozitat e këtij neni kanë lidhje me ofruesin e shërbimeve të hostimit. Ato e detyrojnë atë që kur merr dijeni për çfarëdo informacioni që ngre një dyshim se një vepër penale që përfshin një kërcënim ndaj jetës ose sigurisë së një personi ose personash ka ndodhur, po ndodh ose ka gjasa të ndodhë, ai do të informojë menjëherë autoritetet e zbatimit të ligjit ose autoritetet gjyqësore të Republikës së

Shqipërisë. Në vijim dispozita parashikon detyrimin e ofruesit të shërbimeve të hostimit në momentin që kur nuk mund të identifikojë me siguri të arsyeshme nëse vepra penale është kryer brenda Republikës së Shqipërisë, por ka një dyshim të arsyeshëm për këtë, ai ka detyrim sipas këtij neni që të informojë autoritetin kompetent, autoritetin gjyqësor dhe Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale të Republikës së Shqipërisë.

Seksioni 3 — Dispozita shitesë të zbatueshme për ofruesit e platformave online

Neni 19, Përjashtimet për ndërmarrjet mikro dhe të vogla, mikrondërmarrjet dhe ndërmarrjet e vogla përjashtohen nga disa detyrime, përveç nëse përcaktohen si platforma shumë të mëdha, siç përkufizohet nga Ligjin 43/2022, nga kërkesat më të rrepta të këtij Kreu, me përjashtim të detyrimit për transparencë. Ky nen sqaron fushën e detyrimeve për platformat online pasi platformat që vetëm së fundmi kanë humbur statusin e NVM-ve mbeten të përjashtuara për një periudhë kalimtare prej 12 muajsh. Megjithatë, përjashtimi nuk zbatohet për platformat e përcaktuara si platformat shumë të mëdha online (VLOPs) pavarësisht statusit të tyre si NVM.

Neni 20, Sistemi i brendshëm i trajtimit të ankesave, ky nen ka dispozita në lidhje me ofruesit e platformave online të cilët u ofrojnë marrësve të shërbimit, duke përfshirë individë ose subjekte që kanë paraqitur një njoftim, për një periudhë prej të paktën gjashtë muajsh pas vendimit të përmendur në këtë paragraf, akses në një sistem të brendshëm efektiv të trajtimit të ankesave që u mundëson atyre të paraqesin ankesa, në mënyrë elektronike dhe pa pagesë, kundër vendimit të marrë nga ofruesi i platformës online pas marrjes së një njoftimi ose kundër vendimeve të mëposhtme të marra nga ofruesi i platformës online mbi bazën se informacioni i dhënë nga marrësit përbën përmbytje të paligjshme ose është i papajtueshëm me kushtet dhe afatet e saj. Platformat duhet të sigurojnë që sistemi të jetë i përshtatshëm për përdoruesit, të lejojë ankesa të sakta dhe të argumentuara, dhe që ankesat të trajtohen me kujdes, në mënyrë të drejtë dhe pa diskriminim. Nëse një ankesë tregon se vendimi fillestar ishte i pabazuar, platforma duhet ta anulojë atë menjëherë. Përdoruesit duhet të informohen për rezultatin, arsyet e vendimit dhe mundësitë e disponueshme të ankimit, përfshirë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës. E rëndësishmja, vendimet përfundimtare duhet të mbikëqyren nga staf i kualifikuar dhe të mos mbështeten vetëm te mjetet e automatizuara. Në vijim ka dispozita po për këta ofrues, sistemet e tyre dhe mënyrën e trajtimit të ankesave.

Neni 21, Zgjidhja jashtëgjyqësore e mosmarrëveshjeve, ky nen ju jep të drejtë marrësve të shërbimit, të zgjedhin çdo organ të zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve që është çertifikuar, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lidhen me ato vendime, përfshirë ankesat që nuk janë zgjidhur nëpërmjet sistemit të brendshëm të trajtimit të ankesave. Të dyja palët angazhohen, në mirëbesim, me organin e përzgjedhur të çertifikuar për zgjidhjen jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Pika 3 ka dispozita në lidhje me të gjitha kushtet që Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale do t'i duhen për të çertifikuar organin për zgjidhjen jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve. Dispozitat vijuese të këtij neni kanë të bëjnë me organet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë gjyqësore dhe bashkëpunimit me Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale. Gjithashtu po sipas këtyre dispozitave, Koordinatori i Shërbimeve Digjitale ka detyrim të publikojë në faqen e tij të internetit listën e organeve të zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve që janë çertifikuar dhe certifikimi i të cilëve është revokuar. Organet e certifikuara për zgjidhjen jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, bëjnë të disponueshme vendimet e tyre për palët brenda një afati të arsyeshëm, por jo më vonë se 90 ditë kalendarike nga marrja e ankesës. Në rast mosmarrëveshjesh veçanërisht komplekse, ky afat mund të zgjatet edhe për 90 ditë të tjera, duke mos tejkaluar në total 180 ditë. Nëse organi i zgjidhjes jashtëgjyqësore të

mosmarrëveshjeve, vendos në favor të marrësit të shërbimit, përfshirë individin ose subjektin që ka paraqitur njoftim, ofruesi i platformës online përballon të gjitha tarifat e organit dhe rimbursen marrësin, përfshirë individin ose subjektin, për çdo shpenzim tjetër të arsyeshëm të bërë në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 22, Sinjalizuesit e besuar, (trusted flagers), ky nen ka përcaktime për zgjedhjen dhe listimin e subjekteve të posaçme të njohura për ekspertizën e tyre në identifikimin e përmbajtjes së paligjshme. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale u jep statusin e sinjalizuesit të besuar subjekteve të pavarura, kompetente, dhe u kërkon atyre të publikojnë raporte vjetore mbi veprimtaritë e tyre për të siguruar transparencë dhe pavarësi. Nëse një sinjalizues i besuar paraqet njoftime të pasakta ose të mbështetura dobët, platformat duhet të informojnë Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale, i cili mund të pezullojë ose revokojë statusin e tyre pas hetimit. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale mund të nxjerrë gjithashtu udhëzime, në përputhje me standardet e EU, për të ndihmuar platformat t'i zbatojnë këto rregulla. Sipas dispozitave të po këtij neni sinjalizuesit e besuar publikojnë, të paktën një herë në vit, raporte të qarta, të kuptueshme dhe të detajuara mbi njoftimet e paraqitura në përputhje me nenin 16 të këtij ligji, gjatë periudhës përkatëse. Dispozitat vijuese përcaktojnë detyrime për përmbajtjen e raporteve dhe detyrime të ofruesve të platformave online, në lidhje me njoftimet e pasakta të paraqitura nga sinjalizuesit e besuar dhe detyrime për koordinatorin e shërbimeve digjitale, i cili mund të revokojë statusin e sinjalizuesve të besuar pas një hetimi të kryer me iniciativën e vet, si dhe detyrimin për të nxjerrë udhëzime të bazuara në udhëzimet e Komisionit Evropian.

Neni 23, Masat dhe mbrojtja kundër abuzimit, ky nen përmban dispozita për masat kundër keqpërdorimit të platformave online. Ofruesit duhet të pezullojnë shërbimet, pas paralajmërimit, për përdoruesit që ndajnë në mënyrë të përsëritur përmbajtje haptazi të paligjshme. Ata duhet gjithashtu të pezullojnë përpunimin e njoftimeve ose ankesave nga individë ose subjekte që paraqesin shpesh pretendime të pabazuara. Vendimet për pezullim duhet të merren rast pas rasti, duke marrë në konsideratë faktorë të tillë si numri dhe përqindja e paraqitjeve të paligjshme ose të pabazuara, serioziteti i tyre, pasojat dhe qëllimi. Platformat duhet të përcaktojnë qartë në termat dhe kushtet e tyre politikat e tyre për keqpërdorimin, duke përfshirë shembuj dhe kohëzgjatjen e pezullimeve. Gjithashtu sipas dispozitave të këtij neni ofruesit e platformave online duhet të përcaktojnë, në mënyrë të qartë dhe të detajuar, në kushtet dhe afatet e tyre politikën e tyre në lidhje me keqpërdorimin dhe duhet të japin shembuj të fakteve dhe rrethanave që marrin parasysh kur vlerësojnë nëse një sjellje e caktuar përbën keqpërdorim dhe kohëzgjatjen e pezullimit.

Neni 24, Raportimi i transparencës për platformat online. Me anë të dispozitave të këtij neni detyrohen platformat online të publikojnë raporte vjetore transparence mbi moderimin e përmbajtjes dhe funksionimin e platformës. Raportet duhet të përfshijnë të dhëna mbi urdhrat e autoriteteve, përmbajtjet e hequra ose të kufizuara, përdorimin e sistemeve automatike të moderimit, ankesat e përdoruesve, pezullimet e llogarive dhe numrin e përdoruesve aktivë. Qëllimi është rritja e transparencës dhe llogaridhënies së platformave online. Neni vijon me dispozita detyruese për ofruesit e platformave dhe publikimet e tyre dhe detyrimin për komunikimin e informacionit tek Koordinatori i Shërbimeve Digjitale. Sipas dispozitave të këtij neni roli i Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale lidhet kryesisht me mbikqyrjen dhe verifikimin e detyrimeve të transparencës së platformave online. Gjithashtu po sipas këtij neni Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, në koordinim me autoritetet kompetente, ka fuqinë për të miratuar akte zbatuese, lidhur me përcaktimin e modeleve, me formën, përmbajtjen dhe detaje të tjera të raporteve, në përputhje me praktikën e Komisionit Evropian.

Neni 25, Projektimi dhe organizimi i ndërfaqes online, ky nen ka detyrime për platformat online, duke i ndaluar ato me dispozitat e veta që të projektojnë ose të operojnë ndërfaqet e tyre në mënyra që mashtrojnë, manipulojnë, ose dëmtojnë aftësinë e përdoruesve për të bërë zgjedhje të lira dhe të informuara. Kjo dispozitë nuk çënon legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave, i cili trajtohet veçmas. Koordinator i Shërbimeve Digjitale, së bashku me autoritetet kompetente, do të transpozojë udhëzimet e Komisionit, për mënyrën sesi zbatohen dispozitat e këtij neni ndaj praktikave specifike.

Neni 26, Reklamat në platformat online, me anë të këtij neni vendosen kërkesa për transparencën e reklamave online. Platformat që shfaqin reklama online të etiketojnë qartë reklamat, të identifikojnë kush qëndron pas tyre dhe kush ka paguar për to, dhe t'u ofrojnë përdoruesve informacion të aksesueshëm për arsyen pse ata janë shënjestruar. Sipas dispozitave të këtij neni, platformat duhet gjithashtu t'u lejojnë përdoruesve të deklarojnë kur përmbajtja e tyre përmban komunikime tregtare, duke siguruar transparencë për marrësit e tjerë. Me rëndësi, platformat ndalohen të paraqesin reklama të bazuara në profilizimi sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave.

Neni 27, Transparenca e sistemeve rekomanduese. Qëllimi i nenit është rregullimi i përdorimit të sistemeve rekomanduese nga platformat online. Ky nen me dispozitat e tij paarrshikon që platformat online duhet të sigurojnë transparencë mbi sistemet rekomanduese që përdorin për sugjerimin e përmbajtjeve, produkteve apo profileve. Ato duhet t'u shpjegojnë përdoruesve në mënyrë të qartë parametrat kryesorë mbi të cilët bazohen rekomandimet dhe arsyen pse u shfaqet një përmbajtje e caktuar. Gjithashtu përdoruesve duhet t'u ofrohet të paktën një opsion rekomandimi që nuk bazohet në profilizim.

Neni 28, Mbrojtja e të miturve në internet, sipas dispozitave të këtij neni kërkohet që platformat të miratojnë masa mbrojtëse të posaçme për të miturit. Duhet të marrin masa të përshtatshme dhe proporcionale për të garantuar një nivel të lartë privatësie, sigurie dhe mbrojtjeje për këtë kategori përdoruesish dhe duhet t'i projektojnë shërbimet e tyre për të mbrojtur fëmijët nga praktikët e dëmshme ose manipuluese, duke përfshirë ndalimin e profilizimit të të miturve për qëllime reklamimi ose rekomandimi. Thëksi vihet në krijimin e mjediseve të përshtatshme, duke siguruar që kushtet dhe termat të jenë të kuptueshme për të miturit, dhe duke parandaluar përdorimin shfrytëzues të të dhënave të tyre. Në praktikë, kjo nënkupton kontrolle më të rrepta mbi reklamimin e synuar, sistemet e rekomandimit dhe projektimin e ndërfaqes kur përfshihen të miturit.

Seksioni 4 — Dispozita shpeshë të zbatueshme për ofruesit e platformave në internet që u lejojnë konsumatorëve të lidhin kontrata në distancë me tregtarët

Neni 29, Përrjashtime për ndërmarrjet mikro dhe të vogla, sipas dispozitave të këtij neni ky kre nuk zbatohet për ofruesit e platformave në internet që u lejojnë konsumatorëve të lidhin kontrata në distancë me tregtarë që kualifikohen si NVM siç përcaktohet nga Ligji 43/2022. Ky Seksion nuk do të zbatohet për ofruesit e platformave online që u lejojnë konsumatorëve të lidhin kontrata në distancë me tregtarë që më parë kualifikoheshin për statusin e një SME-je gjatë 12 muajve pas humbjes së atij statusi.

Neni 30, Gjurmueshmëria e Tregtarëve, sipas dispozitave të këtij neni, parashikohet detyrimi i platformave online që lejojnë shitjen e produkteve ose shërbimeve të sigurojnë gjurmueshmërinë e tregtarëve. Platformat mbledhin dhe verifikojnë informacionin kryesor të tregtarëve si identiteti, kontaktet, dokumentet e regjistrimit dhe të dhënat bankare, përpara se t'u lejojnë aktivitetin në platformë. Qëllimi është rritja e sigurisë së konsumatorëve, luftimi i tregtisë së paligjshme dhe garantimi i llogaridhënies së tregtarëve online.

Neni 31, Pajtuëshmëria në fazën e projektimit, ky nen sqaron se platformat duhet t'i projektojnë ndërfaqet dhe sistemet e tyre për të mbështetur pajtuëshmërinë e tregtarëve me ligjet për mbrojtjen e konsumatorit dhe sigurinë e produkteve. Ofruesit e platformave online që u lejojnë konsumatorëve të lidhin kontrata në distancë me tregtarët sigurojnë që ndërfaqja e tyre online të jetë projektuar dhe organizuar në një mënyrë që u mundëson tregtarëve të përmbushin detyrimet e tyre në lidhje me informacionin parakontraktor, informacionin për përputhshmërinë dhe sigurinë e produktit. Kjo do të thotë se mënyra se si strukturohen listimet, ofertat dhe transaksionet duhet të lehtësojë transparencën dhe përputhshmërinë ligjore. Neni vijon me dispozita për ofruesit e platformave online, që u lejojnë konsumatorëve të lidhin kontrata në distancë me tregtarë do të bëjnë përpjekjet më të mira për të vlerësuar nëse tregtarë të tillë kanë dhënë informacionin e duhur përpara se t'u lejojnë atyre të ofrojnë produktet ose shërbimet e tyre në ato platforma. Pasi t'i lejojë tregtarit të ofrojë produkte ose shërbime në platformën e vet online që u lejon konsumatorëve të lidhin kontrata në distancë me tregtarë, ofruesi do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të kontrolluar rastësisht në çdo bazë të dhënash online ose ndërfaqe online zyrtare, lirisht të aksesueshme dhe të lexueshme nga pajisjet nëse produktet ose shërbimet e ofruara janë identifikuar si të paligjshme.

Neni 32, E drejta për informim, dispozitat e këtij neni rrisin besimin e konsumatorëve dhe llogaridhënien, duke siguruar që platformat të veprojnë me përgjegjësi kur mallra të paligjshme zbulohen në tregun e tyre dhe për më tej detajon se kur një ofrues i një platforme online që u lejon konsumatorëve të lidhin kontrata në distancë me tregtarë vihet në dijeni, se një produkt ose shërbim i paligjshëm është ofruar nga një tregtar konsumatorëve të ndodhur në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet shërbimeve të tij, ai ofrues do të informojë, për aq sa i disponon të dhënat e tyre të kontaktit, konsumatorët që blenë produktin ose shërbimin e paligjshëm nëpërmjet shërbimeve të tij për sa vijon: fakti që produkti ose shërbimi është i paligjshëm; identiteti i tregtarit; dhe çdo mjet relevant ankimi. Sipas po këtij neni në rastin kur ofruesi i platformës online që u lejon konsumatorëve të lidhin kontrata në distancë me tregtarët nuk i ka të dhënat e kontaktit të të gjithë konsumatorëve të prekur, ai ofrues do të vërë në dispozicion publikisht dhe lehtësisht të aksesueshëm në ndërfaqen e tij online informacionin në lidhje me produktin ose shërbimin e paligjshëm, identitetin e tregtarit dhe çdo mjet përkatës të kompensimitkonsumatorët fitojnë të drejtën për t'u informuar nëse kanë blerë produkte ose shërbime të paligjshme përmes një platforme. Ofruesit duhet të njoftojnë përdoruesit e prekur menjëherë dhe qartë, duke u mundësuar atyre të ndërmarrin veprimet e duhura, siç janë kërkimi i rimbursimeve ose raportimi i çështjes. Kjo dispozitë rrit besimin e konsumatorëve dhe llogaridhënien, duke siguruar që platformat të veprojnë me përgjegjësi kur mallra të paligjshme zbulohen në tregun e tyre

Seksioni 5 — Detyrime shtesë për ofruesit e platformave online shumë të mëdha dhe motorëve të kërkimit online shumë të mëdhenj për menaxhimin e rrezeqeve sistemike

Neni 33, Platformat online shumë të mëdha dhe motorët e kërkimit online shumë të mëdhenj, ky nen, përcakton se si emërtohen Platformat shumë të mëdha online(VLOPSE-të), si dhe motorët shumë të mëdhenj të kërkimit online. gjithashtu detyrimin e Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale për publikimin e listës së platformave shumë të mëdha të kërkimit online dhe motorët e kërkimit online dhe për vijimin e procedurës së përditësimit të listës. Ky nen gjithashtu përcakton se VLOPSE-të në Shqipëri do të jenë platformat online dhe motorët e kërkimit online, të cilat janë përcaktuar si platforma online shumë të mëdha dhe motorë kërkimi online shumë të mëdhenj nga Komisioni Evropian, pavarësisht nga numri i marrësve aktivë në Republikën e Shqipërisë, përveç atyre që nuk ofrojnë shërbime në Shqipëri. Ky nen do të shfuqizohet nga momenti e anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Neni 34, Vlerësimi i rrezikut, ky nen përmban dispozita për ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, që do të identifikojnë, analizojnë dhe vlerësojnë me kujdes çdo rrezik që ndikon gjithë sistemin në Republikën e Shqipërisë që buron nga projektimi ose funksionimi i shërbimit të tyre dhe sistemeve të lidhura me të, duke përfshirë sistemet algoritmike, ose nga përdorimi i bërë i shërbimeve të tyre. Ata do të kryejnë vlerësimet e rrezikut deri në datën e caktimit në Shqipëri dhe të paktën një herë në vit pas kësaj dhe në çdo rast përpara vendosjes në përdorim të funksionaliteteve që ka të ngjarë të kenë një ndikim kritik mbi rreziqet e identifikuar në përputhje me këtë nen. VLOPSEs duhet të kryejnë vlerësime vjetore të rrezikut për gjithë sistemin, për të identifikuar se si shërbimet e tyre mund të ndikojnë negativisht në shoqëri. Këto rreziqe përfshijnë përhapjen e përmbajtjes së paligjshme, dezinformimin, kërcënimet ndaj të drejtave themelore, manipulimin e proceseve zgjedhore, shqetësimet për sigurinë publike dhe ndikimet në shëndetin mendor. Vlerësimet duhet të jenë të plota, të bazuara në prova dhe të marrin parasysh si faktorët teknologjikë ashtu edhe ata organizativë. Kjo kërkesë siguron që platformat të monitorojnë në mënyrë proaktive dhe të kuptojnë pasojat më të gjera të operacioneve të tyre, në vend që të reagojnë vetëm pasi të ndodhë dëmi. Ky nen do të shfuqizohet nga momenti që Shqipërisë t'i jepet Aksesit në EU.

Neni 35, Masat për zbutjen e rreziqeve, trajton vlerësimet e rrezikut, që VLOPSE-të kërkohet të miratojnë masa proporcionale dhe efektive për të zbutur rreziqet e identifikuar. Këto masa mund të përfshijnë ndryshime në algoritme, politika më të rrepta të moderimit të përmbajtjes, transparencë të shtuar, bashkëpunim me autoritetet, ose kontrole të përmirësuara të përdoruesit. Parimi i proporcionalitetit është thelbësor: platformat duhet të balancojnë uljen e rrezikut me respektimin e të drejtave themelore si liria e shprehjes dhe privatësia. Ky nen siguron që platformat jo vetëm të identifikojnë rreziqet, por edhe të ndërmarrin hapa konkretë për t'i trajtuar ato me përgjegjësi. Gjithashtu ky nen përmban dispozita edhe për Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale, i cili publikon raporte gjithëpërfshirëse një herë në vit dhe ka të drejtë të nxjerrë udhëzime për zbatimin e pikës 1 të këtij neni, në lidhje me rreziqe specifike, në veçanti për të paraqitur praktikatat më të mira dhe për të rekomanduar masa të mundshme, duke marrë siç duhet parasysh pasojat e mundshme të masave mbi të drejtat e të gjitha palëve të përfshira. Ky nen do të shfuqizohet nga momenti që Shqipërisë t'i jepet Aksesit në EU.

Neni 36, Mekanizmi i reagimit ndaj krizave, paraqet dispozita mbi mekanizmin e reagimit ndaj krizave, një nga dispozitat më të ndjeshme të DSA. Dispozitat e këtij neni zbatohen vetëm për Platformat Shumë të Mëdha Online (VLOPs) dhe Motorët Shumë të Mëdhenj të Kërkimit Online (VLOSEs), për shkak të ndikimit të tyre në sistem dhe në diskursin publik, aksesin në informacion dhe stabilitetin shoqëror. Qëllimi i tij është të lejojë ndërhyrje të shpejtë kur një ngjarje e jashtëzakonshme krijon një kërcënim serioz për sigurinë publike ose shëndetin publik brenda Bashkimit Europian dhe kur funksionimi i platformave shumë të mëdha mund të kontribuojë ndjeshëm në përhapjen ose amplifikimin e atij kërcënimi. Shembuj tipikë mund të përfshijnë luftën ose konfliktin e armatosur, sulmet terroriste, emergjencat e mëdha të shëndetit publik si pandemitë, fatkeqësitë natyrore me efekte të mëdha ndërkufitare, fushata të rënda dezinformimi që prekin institucionet demokratike ose sigurinë publike.

Në Shqipëri, ky nen përmban dispozita për Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale, i cili ka të drejtë të monitorojë zbatimin e masave specifike të marra në mbështetje të aktit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, në bazë të raporteve të përmendura në pikën (c) të atij paragrafi dhe të çdo informacioni tjetër përkatës, përfshirë informacionin që ai mund të kërkojë në mbështetje të nenit 40, duke marrë parasysh evoluimin e situatës së krizës.

Kur Koordinator i Shërbimeve Digjitale vlerëson se masat specifike të parashikuara ose të zbatuara në përputhje me pikën (b) të paragrafit (1) nuk janë efektive ose proporcionale, ka të drejtë të nxjerrë një vendim të ri duke i kërkuar ofruesit të rishikojë masat specifike të identifikuar ose mënyrën e zbatimit të tyre.

Me fjalë të tjera, Neni 36 nuk krijon një detyrim krejtësisht të ri; ai përshpejton dhe intensifikon kuadrin ekzistues të menaxhimit të rrezikut kur një ngjarje e jashtëzakonshme kërkon veprim urgjent. Ky nen do të shfuqizohet nga momenti e anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Neni 37, Auditimi i pavarur, mbart detyrime për ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe të motorëve të kërkimit shumë të mëdhenj online që do t'i nënshtrohen, me shpenzimet e tyre dhe të paktën një herë në vit, auditimeve të pavarura për të vlerësuar përputhshmërinë me sa detyrimet e caktuara. Gjithashtu dispozita për platformat shumë të mëdha në internet dhe motorët e kërkimit të kryejnë auditime vjetore, të pavarura me shpenzimet e tyre për të vlerësuar përputhshmërinë me detyrimet ligjore, kodet e sjelljes dhe protokollet e krizës. Ka dispozita për auditimet që do të sigurojnë një nivel të përshtatshëm konfidencialiteti dhe sekreti profesional, në lidhje me informacionin e marrë nga ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe të motorëve të kërkimit shumë të mëdha online, si dhe nga palë të treta në kontekstin e auditimeve. Pajtueshmëria me këtë kërkesë nuk do të ndikojë negativisht në kryerjen e auditimeve dhe dispozitave të tjera të këtij ligji, në veçanti dispozitave për transparencën, mbikëqyrjen dhe zbatimin. Kur është e nevojshme për qëllimet e raportimit të transparencës në përputhje me nenin 42(4), raporti i auditimit dhe raporti mbi zbatimin e ndjekjes së rekomanduar nga auditimi, të përmendur në paragrafët 5 dhe 7, do të shoqërohen me versione që nuk përmbajnë asnjë informacion që mund të konsiderohet në mënyrë të arsyeshme konfidencial. Auditimet pra duhet të kryhen nga organizata të kualifikuara, të pavarura, me bashkëpunim të plotë nga platformat dhe të rezultojnë në raporte të detajuara që përfshijnë konstatime, opinione dhe rekomandime. Platformat duhet të zbatojnë ose të justifikojnë përgjigjet ndaj rekomandimeve të auditimit, ndërsa Koordinator i Shërbimeve Digjitale, vendos rregulla dhe mbikëqyr procesin e auditimit. Koordinator i Shërbimeve Digjitale ka të drejtë të miratojë rregullat e nevojshme për zhvillimin e auditimeve në përputhje me këtë nen, në veçanti për sa u përket rregullave të nevojshme mbi hapat proceduralë, metodologjitë e auditimit dhe modelet e raportimit për auditimet e kryera në përputhje me këtë nen. Ky nen do të shfuqizohet nga momenti e anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Neni 38, Sistemet e rekomandimit, dispozitat kërkojnë që platformat dhe motorët e kërkimit shumë të mëdhenj t'u japin përdoruesve të paktën një mundësi rekomandimi që nuk bazohet në profilizimin e të dhënave personale. Në praktikë, kjo siguron që përdoruesit të mund të zgjedhin një mënyrë neutrale, duke mbrojtur privatësinë dhe duke kufizuar të dhënat. Ky nen do të shfuqizohet nga momenti e anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Neni 39, Detyrime shtesë për transparencën për reklamën online, ky nen përmban dispozita për ofruesit e platformave shumë të mëdha online ose të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, që paraqesin reklama në ndërfaqet e tyre online që duhet të përpilojnë dhe të vënë në dispozicion të publikut, në një seksion specifik të ndërfaqes së tyre online, nëpërmjet një mjeti të besueshëm dhe të pyetshëm, që lejon kërkime me shumë kritere, dhe nëpërmjet ndërfaqeve të programimit të aplikacioneve, një regjistër që përmban informacionin e përmendur në paragrafin 2, gjatë gjithë periudhës gjatë së cilës ata paraqesin reklamën dhe për një periudhë prej një viti pasi reklama është paraqitur për herë të fundit në ndërfaqet e tyre online. Këta ofrues duhet të sigurojnë që regjistri të mos përmbajë të dhënat personale të marrësve të shërbimit të cilëve reklama u është paraqitur ose mund t'u jetë

paraqitur dhe duhet të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të siguruar që informacioni të jetë i saktë dhe i plotë. Gjithashtu dispozitat vijnë me çfarë duhet të përfshijë regjistri dhe të drejtën që ka Koordinatorin i Shërbimeve Digjitale të nxjerrë udhëzime për strukturën, organizimin dhe funksionet e regjistrave. Ky nen do të shfuqizohet nga momenti e anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Neni 40, Aksesin në të dhëna dhe shqyrtimi, kërkon që platformat dhe motorët e kërkimit shumë të mëdhenj t'i japin Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale akses në të dhënat e nevojshme për të monitoruar pajtueshmërinë, përfshirë shpjegime se si funksionojnë algoritmet dhe sistemet e tyre të rekomandimit. Koordinatorin mund t'u japë gjithashtu studiuesve të verifikuar akses në të dhënat e platformës për studime mbi rreziqet sistematike, me kusht që të përmbushen pavarësia e rreptë, konfidencialiteti dhe publiku-kushtet e interesit përmbushen. Platformat duhet të bashkëpunojnë, por mund të kërkojnë ndryshime nëse të dhënat nuk janë të disponueshme ose paraqesin rreziqe sigurie. Pra ky nen përmban detyrime për ofruesit e platformave online shumë të mëdha ose të motorëve të kërkimit online shumë të mëdhenj që do t'i sigurojnë Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale, me kërkesën e tij të arsyetuar dhe brenda një periudhe të arsyeshme të treguar në atë kërkesë, akses në të dhënat e nevojshme për të monitoruar dhe vlerësuar pajtueshmërinë me këtë ligj, si dhe detyrime për Koordinatorin që t'i përdorë të dhënat e aksesuara, vetëm për qëllimin e monitorimit dhe vlerësimit të pajtueshmërisë me këtë ligj, duke respektuar të drejtat dhe interesat e ofruesve të platformave shumë të mëdha online ose të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online dhe të përfituesve të shërbimit përkatës, duke siguruar mbrojtjen e të dhënave personale, mbrojtjen e informacionit konfidencial, në veçanti të sekreteve tregtare, dhe ruajtjen e sigurisë së shërbimeve të tyre. Gjithashtu në dispozitat vijuese sqarohen të drejta dhe detyrime për koordinatorin dhe ofruesit në lidhje me aksesin në të dhëna, aplikimin, dhe detyrimin e Koordinatorit për të njoftuar Komisionin dhe Bordin. Dispozitat vijnë me dispozita për studiuesit e verifikuar dhe vijimin e mbajtjes së statusit të tyre. Ky nen do të shfuqizohet nga momenti kur Shqipërisë t'i jepet Aksesin në EU.

Neni 41, Funksioni i përputhshmërisë, dispozitat e nenit kërkojnë që platformat dhe motorët e kërkimit shumë të mëdhenj të krijojnë një funksion të pavarur pajtueshmërie i udhëhequr nga nëpunës të kualifikuar të pajtueshmërisë. Dispozitat vijuese janë në lidhje me funksionin që duhet të ketë një organ drejtues që siguron siguron që zyrtarët e pajtueshmërisë të kenë kualifikimet profesionale, njohuritë, përvojën dhe kapacitetin e nevojshëm për të kryer detyrat e përmendura në paragrafin 3. Në vijim detajohen detyrat që duhet të kenë zyrtarët e pajtueshmërisë. Këta nëpunës duhet të monitorojnë pajtueshmërinë ligjore, të mbikëqyrin vlerësimet e rrezikut dhe auditimet, të këshillojnë drejtuesit, dhe të bashkëpunojnë me rregullatorët. Nëpunësi kryesor i pajtueshmërisë duhet të jetë i pavarur, të raportojë drejtpërdrejt te organi drejtues, dhe nuk mund të shkarkohet pa miratimin e tij. Ky nen do të shfuqizohet nga momenti e anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Neni 42, Detyrimet për raportimin e transparencës, ky nen ka dispozita për platformat dhe motorët e kërkimit shumë të mëdhenj online që lidhen me publikimin e raporteve të hollësishme transparence çdo gjashtë muaj, që mbulojnë burimet e moderimit të përmbajtjes, kualifikimet e stafit, treguesit e saktësisë, numrin e përdoruesve dhe rezultatet e auditimit. Ata duhet gjithashtu të ndajnë vlerësimet e rrezikut dhe masat zbutëse, duke mbrojtur informacionin konfidencial kur është e nevojshme. Ky nen do të shfuqizohet nga momenti e anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Neni 43, Tarifa mbikëqyrëse, rregullon sistemin e tarifave të mbikëqyrjes që duhet të paguhet nga Platformat Shumë të Mëdha Online (VLOPs) dhe Motorët Shumë të Mëdhenj të

Kërkimit Online (VLOSEs) për të financuar aktivitetet e mbikëqyrjes të kryera nga institucioni që ngarkohet me aktivitetet e zbatimit. Në Shqipëri ky do të jetë Koordinator i Shërbimeve Digjitale.

Kjo dispozitë pasqyron një parim të rëndësishëm të Aktit të Shërbimeve Digjitale: mbikëqyrja e shtuar e ndërmjetësve më të mëdhenj online, shërbimet e të cilëve gjenerojnë rreziqe shoqërore, duhet të mbështetet financiarisht nga po ata operatorë dhe jo tërësisht nga buxhetet publike. Për shkak se VLOPs dhe VLOSEs i nënshtrohen mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë, neni 43 synon të sigurojë burimet institucionale të nevojshme për hetime, auditime, monitorim, inspektime dhe zbatim të mund të financohen në mënyrë të qëndrueshme.

Tarifa vjetore mbikëqyrëse duhet të jetë proporcionale me madhësinë e shërbimit, veçanërisht me numrin e marrësve aktivë në vend si dhe me kapacitetin ekonomik të ofruesit, përfshirë burimet e tij financiare. Propozimi për nivelin maksimal përcakton një masë mbrojtëse të rëndësishme sipas parashikimeve në Rregulloren e DSA-së. Ky kufi parandalon barra financiare joproporcionale, duke siguruar njëkohësisht që operatorët ekonomikë shumë të mëdhenj të kontribuojnë në mënyrë të drejtë.

Nëse Koordinator i Shërbimeve Digjitale synon të mbledhë tarifën mbikëqyrëse nga VLOPSE-të në Shqipëri për periudhën në të cilën ai kryen veprimtari zbatuese për nenet 33 deri në 43, ai do të duhet të respektojë gjithashtu udhëzimet e Komisionit Evropian. Në të gjitha rastet, nga momenti që Shqipëria anëtarësohet në BE, ky nen do të shfuqizohet dhe tarifa mbikëqyrëse do të mblidhet nga Komisioni i EU.

Seksioni 6 — Dispozita të tjera lidhur me detyrimet e due diligence

Neni 44, Standardet, sqaron se Koordinator i Shërbimeve Digjitale do të mbështesë dhe do të nxisë zhvillimin dhe zbatimin e standardeve vullnetare të përcaktuara nga organet përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit, ai promovon standarde teknike vullnetare për të përmirësuar përputhshmërinë, duke mbuluar fusha si paraqitja e njoftimeve, sistemet e rekomandimit, transparenca e reklamimit, auditimet dhe mbrojtja e të miturve. Standardet duhet të përditësohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet teknologjike. Ky nen do të shfuqizohet nga momenti që Shqipëria anëtarësohet në BE.

Neni 45, Kodet e Sjelljes, përqendrohet në rolin që Koordinator i Shërbimeve Digjitale në koordinim me autoritetet kompetente, mbështet dhe lehtëson zhvillimin e kodeve vullnetare të sjelljes për të kontribuar në zbatimin e duhur të këtij ligji, duke marrë parasysh në veçanti sfidat specifike që rrjedhin nga lloje të ndryshme të përmbajtjes së paligjshme dhe rreziqeve, në veçanti sa i përket konkurrencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Koordinator i Shërbimeve Digjitale në bashkëpunim me autoritetet kompetente dhe kur është e nevojshme organe të tjera, synon të sigurojë që kodet e sjelljes të përcaktojnë qartë objektivat e tyre specifike, të përmbajnë tregues kyç të performancës për të matur arritjen e këtyre objektivave dhe të marrin parasysh siç duhet nevojat dhe interesat e të gjitha palëve të interesuara, dhe në veçanti qytetarëve. Koordinator i Shërbimeve Digjitale në bashkëpunim me autoritetet kompetente synon gjithashtu të sigurojë që pjesëmarrësit t'u raportojnë rregullisht Koordinatorëve të tyre përkatës të Shërbimeve Digjitale të shtetit të themelimit për çdo masë të marrë dhe rezultatet e tyre, të matura kundrejt treguesve kyç të performancës që ato përmbajnë. Këto kode përcaktojnë objektiva, tregues të performancës dhe detyrime raportimi, me monitorim dhe përshtatje të rregullta për të siguruar efektivitetin. Në rast të dështimit sistematik për të respektuar kodet e sjelljes, Koordinator i Shërbimeve Digjitale në bashkëpunim me autoritetet kompetente mund t'i ftojë nënshkruesit e kodeve të sjelljes të ndërmarrin veprimet e nevojshme. Ky nen do të shfuqizohet nga momenti që Shqipëria anëtarësohet në BE.

Neni 46, Kodet e sjelljes për reklamën online, ky nen përcakton dispozita për Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale, i cili nxit kodet e sjelljes midis aktorëve të reklamimit për të përmirësuar transparencën në zinxhirin e vlerës së reklamave. Këto kode synojnë të sigurojnë konkurrencë të ndershme, respekt për privatësinë dhe informacion të qartë mbi monetizimin e të dhënave dhe shënjestrimin. Gjithashtu në koordinim me autoritetet kompetente ai do të inkurajojë të gjithë aktorët në zinxhirin e vlerës së reklamimit në internet të përmendur në paragrafin 1 të mbështesin angazhimet e përcaktuara në kodet e sjelljes, dhe të respektojnë ato. Ky nen do të shfuqizohet nga momenti që Shqipëria anëtarësohet në BE.

Neni 47, Kodet e sjelljes për aksesueshmërinë, përcakton dispozita për Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale i cili në koordinim me autoritetet kompetente, inkurajon dhe lehtëson hartimin e kodeve të sjelljes me përfshirjen e ofruesve të platformave online dhe të tjerëve ofruesit përkatës të shërbimeve, organizatat që përfaqësojnë marrësit e shërbimit dhe organizatat e shoqërisë civile ose autoritetet përkatëse për të promovuar pjesëmarrje të plotë dhe efektive, të barabartë, duke përmirësuar aksesin në shërbimet online që, përmes projektimit të tyre fillestar ose përshtatjes së mëvonshme, trajtojnë nevojat e veçanta të personave me aftësi të kufizuara. Ata promovohen për t'i bërë shërbimet online të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara. Ato përqendrohen në projektimin e shërbimeve që janë të perceptueshme, të përdorshme, të kuptueshme dhe të qëndrueshme, me informacion të qartë publik mbi përputhshmërinë me aksesueshmërinë. Ky nen do të shfuqizohet nga momenti që Shqipëria anëtarësohet në BE.

Neni 48, Protokollet e krizës, dispozitat e këtij neni përcaktojnë që Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale mund të nxisë protokolle vullnetare krize për situata të jashtëzakonshme, që prekin sigurinë publike ose shëndetin. Këto protokolle përcaktojnë rolet, procedurat e aktivizimit, masat mbrojtëse për të drejtat themelore dhe detyrimet e raportimit, duke siguruar që platformat të përgjigjen me përgjegjësi gjatë krizave. Ky nen do të shfuqizohet nga momenti që Shqipëria anëtarësohet në BE.

Kreu IV — Zbatimi, bashkëpunimi, sanksionet dhe ekzekutimi

Seksioni 1 — Autoritetet kompetente dhe Koordinatorët Kombëtarë të Shërbimeve Digjitale

Neni 49, Autoritetet Kompetente dhe Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale, ky nen përcakton autoritetet kompetente të ngarkuara për të mbikëqyrur dhe zbatuar ligjin:

- AMA organi rregullator për median
- AKEP organi rregullator për sektorin e komunikimeve elektronike
- Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale
- Autoriteti i konkurrencës
- Agjencia e mbrojtjes së konsumatorit
- Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike
- Ministria përgjegjëse për zbatimin e dispozitave kundër terrorizmit dhe nxitjes për terrorizëm;
- Ministria përgjegjëse për zbatimin e dispozitave mbi të drejtën e autorit

Neni 49, ka parashikuar gjithashtu përcaktimin e Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale, si autoriteti përgjegjës për koordinimin ndërmjet organeve dhe autoriteteve të tjera përkatëse gjyqësore, administrative dhe kompetente, dhe përgjegjës për zbatimin e ligjit. Propozimi për caktimin e DSC në Shqipëri bazohet në praktikën e vendeve të Bashkimit Evropian ku roli i koordinatorit në një pjesë të mirë të rasteve i është caktuar organit rregullator të

komunikimeve elektronike/telekomunikacionit si në rastin e Gjermanisë, Kroacisë, Sllovenisë, Greqisë, Bullgarisë, Lituanisë, Suedisë. Në disa raste ky rol i është caktuar organit rregullator për median si në Austri, Francë, dhe në disa raste të tjera tek organi rregullator që përgjigjet njëkohësisht për të dy sektorët si në rastin e Italisë. Në më pak raste ky rol i është caktuar autoritetit për konkurrencën ose mbrojtjen e konsumatorit. Në të gjitha rastet përmbushja e detyrave sipas DSA parashikon bashkëpunimin dhe koordinimin e DSC me autoritetet e tjera kompetente. Sipas këtij modeli neni 49, përmban dispozita në lidhje me Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale, i cili do bashkëpunojë me çdo autoritet publik administrativ dhe gjyqësor në kryerjen e detyrave për qëllimet e këtij ligji.

Neni 50, Kërkesat për Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale, dispozitat e këtij neni garantojnë që Koordinatori i Shërbimeve Digjitale të funksionojë në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe transparente. Ata duhet të kenë burime të mjaftueshme teknike, financiare dhe njerëzore për të mbikëqyrur shërbimet online në mënyrë efektive, me autonomi në menaxhimin e buxheteve të tyre. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale duhet të mbetet i lirë nga ndikimi i jashtëm, ndërkohë që bashkëpunojnë me autoritete të tjera dhe i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor dhe llogaridhënies proporcionale.

Neni 51, Kompetencat e Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale, ky nen me dispozitat e tij i jep Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale kompetenca hetimore dhe zbatuese për të mbikëqyrur shërbimet ndërmjetëse. DSC mund të kërkojë informacion, të kryejë inspektime dhe marrë masa për zbatimin e detyrimeve ligjore. Në raste të rënda kur shkeljet shkaktojnë dëm serioz, Koordinatori i Shërbimeve Digjitale mund t'u kërkojë ofruesve të miratojnë plane veprimi ose t'u kërkojë autoriteteve gjyqësore të kufizojnë përkohësisht qasjen në shërbime. Të gjitha masat duhet të jenë efektive, proporcionale dhe parandaluese, duke siguruar që platformat të jenë në përputhje me ligjin, ndërsa mbrojnë aksesin e ligjshëm dhe të drejtat themelore.

Neni 52, Sanksionet, ky nen parashikon vendosjen e sanksioneve dhe përcakton rregullat për vendosjen e gjobave dhe masave ndëshkuese ndaj shkeljeve të DSA, gjithashtu i jep kompetencë Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale të vendosë sanksione ndaj ofruesve të shërbimeve ndërmjetëse që shkelin ligjin. Sanksionet duhet të jenë efektive, proporcionale dhe dekurajuese. Neni përmban përcaktime për nivelin e gjobave në përputhje të plotë me parashikimet e Rregullores së BE-së 2022/2065/EU, konkretisht me nenin 52, të saj.

Neni 53, E drejta për të paraqitur ankesë, ka dispozita në lidhje me të drejtën e marrësit të shërbimeve në internet dhe organizatave të autorizuar, për të paraqitur ankesa pranë Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale, nëse besojnë se një ofrues ka shkelur ligjin. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale duhet të vlerësojë ankesën, t'ia përcjellë autoritetit përkatës nëse është e nevojshme, dhe të sigurojë që të dyja palët të dëgjohen dhe të mbahen të informuara për procesin.

Neni 54, Kompensimi, trajton mundësinë e marrësit të shërbimeve online të kenë të drejtën të kërkojnë kompensim për dëmet ose humbjet, të shkaktuara nga ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse kur këta ofrues nuk përmbushin detyrimet e tyre ligjore. Kjo siguron llogaridhënie dhe mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve.

Neni 55, Raportet e veprimtarisë, nëpërmjet këtij neni sigurohet transparencë, llogaridhënie dhe mbikëqyrje publike të mënyrës se si Koordinatori i Shërbimeve Digjitale dhe autoritetet kombëtare e zbatojnë ligjin. Ai kërkon që Koordinatori i Shërbimeve Digjitale të publikojë raporte vjetore mbi veprimtaritë e tyre deri më 31 janar të çdo viti. Raportet duhet të përfshijnë numrin e ankesave të marra, masat zbatuese të ndërmarra dhe hollësi të

urdrave kundër përmbytjes së paligjshme ose kërkesave për informacion nga autoritetet kombëtare. Këto raporte duhet të jenë të disponueshme publikisht në një format të lexueshëm nga pajisjet-format të lexueshëm nga pajisjet, duke respektuar njëkohësisht rregullat e konfidencialitetit. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale duhet gjithashtu të përpilojë një raport të vetëm të konsoliduar që mbulon punën e të gjitha autoriteteve kompetente në Shqipëri. Pra qëllimi i këtij neni është rritja e transparencës, llogaridhënies dhe monitorimit të zbatimit të DSA në nivel kombëtar dhe evropian.

Seksioni 2 — Dispozita të përbashkëta për zbatimin

Neni 56, Sekreti profesional, neni përcakton detyrimin e sekretit profesional për të gjithë aktorët e përfshirë në zbatimin e ligjit. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, autoritetet kombëtare, zyrtarët e tyre dhe çdo person i jashtëm si audituesit ose ekspertët e emëruar sipas parashikimeve në ligj, ndalohen të zbulojnë informacionin e përfutur ose të shkëmbyer gjatë zbatimit të ligjit kur ai informacion mbulohet nga detyrime konfidencialiteti.

Neni 57, Sistemi i shkëmbimit të informacionit, kërkon që Koordinatori i Shërbimeve Digjitale të krijojë dhe të mirëmbajë një informacion të sigurt-sistem shkëmbimi për të mbështetur komunikimin me autoritete të tjera kompetente, organe gjyqësore ose administrative kur është e nevojshme për detyrat e tyre.

Neni 58, Përfaqësimi, kjo dispozitë e këtij neni, u mundëson marrësve të shërbimeve ndërmjetëse të mandatojnë një organ, organizatë ose shoqatë për të ushtruar të drejtat e dhëna nga ky ligj në emër të tyre.

KREU IV-Dispozita përfundimtare

Neni 59, Rishikimi, ky nen përcakton detyrimin e Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale, që tre vjet pas miratimit të tij do të vlerësojë dhe raportojë në Kuvend për efektin e zbatimit të këtij ligji përfshirë dhe efektin në zhvillimin dhe rritjen ekonomike të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Neni 60, zbatimin e fazuar të dispozitave të projektligjit duke pasur parasysh kohën e nevojshme për pershtatjen dhe marrjen e masave për zbatim nga ofruesit e shërbimeve duke përcaktuar:

- për nenet 16 deri në 32, të Kreut III, lidhur me dispozitat shtesë të zbatueshme për ofruesit e shërbimeve të hostimit, përfshirë platformat online, dispozitat shtesë të zbatueshme për ofruesit e platformave online dhe dispozitat shtesë të zbatueshme, si dhe nenet 44 deri në 48, të këtij ligji, që përcaktojnë “Dispozita të tjera lidhur me detyrimet e kujdesit të duhur”, do të hyjnë në fuqi 6 muaj pas botimit të këtij Ligji në Fletoren Zyrtare.
- Për nenet nga 33 deri në 48, të këtij ligji, që lidhen me platformat shumë të mëdha online dhe të gjitha referencat ndaj platformave shumë të mëdha online dhe motorëve të kërkimit në ligj, në nenin 14, pika 5 dhe 6, nenin 19, pikat 1 dhe 2, nenin 24, pikat 2 dhe 3, nenin 29, pika 2, nenin 44, pika 1, shkronja e), nenin 45, pika 2, nenin 46, pika 2, shkronja b, nenin 48, pika 2, shkronja b, nenin 51, do të hyjnë në fuqi 12 muaj pas botimit të këtij Ligji në Fletoren Zyrtare.

Gjithashtu duke pasur parasysh që me anëtarësimin në BE, Rregullorja e DSA-së do të zbatohet drejtpërdrejt, është parashikuar që nenet nga 33 deri në 48, të këtij ligji për platformat shumë të mëdha online, shfuqizohen nga momenti i hyrjes në fuqi të traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Neni 61, Hyrja në fuqi. Ky nen përcakton kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, që është 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen autoritetet kompetente sipas përcaktimeve në ligj si dhe Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale;

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Hartimi i projektligjit është bërë me mbështetjen e ekspertit të BE-së, në kuadër të asistencës teknike të BE-së, i EUIS për procesin e integritetit. Procesi i hartimit është drejtuar, koordinuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si ministria përgjegjëse për Kapitullin 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Media” në bashkëpunim me institucionet pjesëmarrëse dhe kontribuese në këtë kapitull që lidhen me zbatimin e parashikimeve të këtij projektligji si: Ministria e Brendshme, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Autoriteti Konkurrencës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Drejtoria për të Drejtën e Autorit, Ministria e Drejtësisë, AKSHI, etj. Në procesin e hartimit të projektligjit, janë mbajtur parasysh udhëzimet e Komisionit Evropian lidhur me transpozimin e DSA nga vendet kandidatë të dhëna në workshopin e TAIEK të zhvilluar nga EC, DG Ennest dhe DG Connect në 12-13 Mars 2026 me vendet kandidatë.

Ministria e Infrastruktures dhe Energjisë gjatë procesit të përgatitjes së këtij projektakti, ka bashkëpunuar me institucionet AMA, AKEP, MEI, MB, AK, KDIMP, MK, MD, AKSHI si dhe Kuvendi.

Takimet ndërinstitucionale për këtë projektligj kanë filluar në vitin 2025, dhe kanë vijuar gjatë vitit 2026, si më poshtë:

- Në muajin maj-qershor 2025 u përgatit analiza e boshllëkut ligjor në kuadër të Reformës Agjendës në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, institucionet e tjera kontribuese si AMA, AKEP, MEKI, DPA etj. Në vijim, gjatë vitit 2025 janë zhvilluar nga MIE dy takime me përfaqësuesit e institucioneve me datë 19 Shtator 2025 dhe 29 Tetor 2025.
- Me 20 Janar 2026, nën drejtimin e zëvendësministres, në cilësinë e negociatores për Kapitullin 10, u zhvillua takimi i dialogut rregullator me pjesëmarrje të nivelit të lartë dhe përfaqësues nga Kuvendi, drejtuesit e organeve rregullatore AMA, AKEP, AK, përfaqësues të institucioneve, shoqërisë civile dhe EUD.
- Në vijim janë zhvilluar katër takime me përfaqësuesit e institucioneve në datat: 31 Mars 2026, 8 Prill 2026, 9 Prill 2026 dhe 10 Prill 2026. Gjithashtu u zhvillua një workshop për metodologjinë e identifikimit të ndërmjetësive të shërbimeve si dhe paralelisht zhvilluar takime bilaterale me institucionet dhe konsulentin e BE-së.

Në kuadër të këtij projektligji janë zhvilluar disa takime, dhe tryeza konsultimi me aktorët e shoqërisë civile, mbrojtjes së konsumatorit, akademisë, ofruesit e shërbimeve etj. Kështu në muajin maj janë zhvilluar tre tryeza dialogimi/diskutimi me shoqërinë civile, përfaqësues të akademisë dhe institucioneve në datat: 12 Maj 2026, 21 dhe 22 Maj 2026.

Gjatë këtyre takimeve është prezantuar dhe diskutuar mbi risitë që sjell Rregullorja e DSA dhe sfidat e zbatimit të saj, kategoritë e ndërmjetësave, detyrimet sipas DSA për ndërmjetësit, për rolin e institucioneve dhe rolin e DSC.

Projektligji i përgatitur do kalojë për konsultim publik në regjistrin e konsultimeve publike si dhe zyrtarisht me institucionet: AMA, AKEP, AK, KDIMP, AKSK, dhe ministritë përmes e-akteve. Projektligji i shoqëruar me tabelat e përputhshmërisë do përcillet gjithashtu pranë Komisionit Evropian për vlerësim.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektligji nuk sjell efekte financiare drejtpërdrejt për buxhetin e shtetit. Zbatimi i dispozitave të këtij ligji, në vecanti lidhur me dispozitat që parashikohen për Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale, që parashikohet të jetë një organ rregullator i pavarur sipas kërkesave të Rregullores së BE-së dhe të nënvizuara në workshopin e TAIEX do të kërkojnë planifikimin dhe përshtatjen e kapaciteteve teknike dhe burimeve njerëzore në përgatitjen operacionale për përmbushjen e detyrave që caktohen nga ky ligj për DSC.